



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT
DIBËR

Nr. 2274 prot.

Peshkopi, më 20.10.2023

VENDIM

Nr. 17, date 20.10.2023

“PËR PROPOZIMIN E ORGANIZATAVE QË DO TË NOMINOHEN PËR ÇMIM NË
DITËN KOMBËTARE TË AKTIVIZIMIT - 2023 ”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 77, gërma “k”, neni 82, gërma “b”, në thirrjen për nominime për çmime në Ditën Kombëtare të Aktivizimit 2023 Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 20.10.2023, pasi shqyrtoi Vendimin e Kryesisë “Për propozimin e organizatave që do të nominohen për çmim në ditën kombëtare të aktivizimit - 2023”, me 14 (katërbëdhjetë) vota “PRO”,

VENDOSI:

1. Të propozojë për nominim për çmimin që do të jepet për kontribut dhe arritje në avokimin e të drejtave, fuqizimin e personave dhe rritjen e shërbimve për të nxitur përfshirjen e aftësisë së kufizuar organizatat:
 - **Fondacioni OAZ, Qendra “Shpresa e Re” – Mat.**
 - **World Vision – Dibër.**
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij Vendimi Sekretari i Këshillit të Qarkut dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.
3. Ky Vendim merr fuqi 10 ditë pas shpalljes.
4. U shpall sot, datë 20. 10.2023.

ZV/KRYETAR
ARMAND GJINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT DIBËR

VENDIM

Nr. 18 Datë 20.10.2023

227/2 prot.

PËR

“MIRATIM NDRYSHIM DESTINACIONI PERDORIMI FONDESH PER BASHKINE KLOS”

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, Ligjit nr. 2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Dibër nr. 17, datë 20.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të K.Q Dibër për vitin 2023”, si dhe bazuar shkresës nr 2466 prot, datë 06.09.2023 të Bashkise Klos,”Për ndryshim destinacioni perdorimi fondi”, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 20.10.23 pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 18, dt. 7.9.23 “Për miratim ndryshim destinacioni perdorim fondesh per Bashkine Klos” me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit te destinacionit te fondit akorduar Bashkise Klos

Ishte :

Transferim foni per Bashkine Klos per pergatitjen e Festivalit te Gjirokastrës Ne shumen 300 000 leke

Te behet:

Fondi te perdoret per Fesk Folk dhe Panair ne Bashkine Klos ne shumen 300 000 leke

2. Të bëhet ndryshimi i destinacionit te fondit ne Bashkine Klos në shumën 300 000 lekë
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, me datë 20.10.2023

ZV/KRYETAR

Armand Gjini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËRNr. 227₃ prot.Peshkopi, më 20.10.2023**VENDIM**Nr. 19 Date 20.10.2023**PËR****MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR SHITESË PENSION TË POSAÇËM
SHTETËROR PËR Z. MEDI HAN LIKA**

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77, neni 5 i Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (Ndryshuar), VKM nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 20.10.2023, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë "Miratim e propozimit për pension të posaçëm shtetëror për z. Medi Han Lika", me 14 (katërbëdhjetë) vota pro,

VENDOSI:

- 1- Ti propozohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror z. Medi Han Lika për arritjen të rezultateve të dallueshme në fushën e Ekonomisë.
- 2-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Projekteve.
- 3-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
- 4-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- 5-U shpall me dt.20.10.2023.

ZV/KRYETAR

Armand Gjini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËRNr. 224/prot.
4

Peshkopi, më 20.10.2023

VENDIM

Nr. 20 Date 20.10.2023

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR PJESËMARRJEN E KRYETARES, STAFIT
DHE KËSHILLTARËVE TË KËSHILLIT TË QARKUT NË TAKIMET E
ORGANIZUAR NGA ASAMBLEJA E RAJONEVE EVROPIANE (AER) DHE
PATNERËVE TË TJERË JASHTË VENDIT**

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77, neni 5 i Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (Ndryshuar), VKM nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 20.10.2023, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë " Për miratimin e propozimit për pjesëmarrjen kryetares, stafit, këshilltarëve të këshillit të qarkut në takimet e organizuar nga asambleja e rajoneve evropiane (AER) dhe patnerëve të tjerë jashtë vendit", me 14 (katërbëdhjetë) vota pro,

VENDOSI:

- 1-Miratim e propozimit për pjesëmarrjen e kryetares, stafit, këshilltarëve të këshillit të qarkut në takimet e organizuar nga Asambleja e Rajoneve Evropiane (AER) dhe patnerëve të tjerë jashtë vendit.
- 2-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër, Sektori Juridik dhe i Projekteve dhe Sektori i Financës.
- 3-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
- 4-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- 5-U shpall me dt.20.10.2023

ZV/KRYETAR

Armand Gjini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT DIBËR

VENDIM

Nr. 21 Datë 20.10.2023

PËR

**“MIRATIM PËR TRANSFERIM TE BAZES MATERIALE SHKOLLES SE MESME
PROFESIONALE “NAZMI RUSHITI”**

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, Ligjit nr. 2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, *Vendimit të Këshillit të Qarkut Dibër nr. 17, datë 20.12.2022* “Për miratimin e Buxhetit të K.Q Dibër për vitin 2023”, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 20.10.23 pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 17, dt. 20.10.23, “Për miratimin e transferimit të bazes materiale (inventar i imet) Shkolles se Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti” me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro,

V E N D O S I :-

1. Miratimin e transferimit të bazes materiale (inventar i imet) Shkolles se Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”
2. Të bëhet transferimi i bazes materiale.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Projekteve, dhe Sektori i Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, me datë 20.10.2023

ZV/KRYETAR

Armand Gjini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR
VENDIM
Nr. 22 Datë 20.10 .2023

PËR

“MIRATIM PËR TRANSFERIM FONDI BASHKISE DIBER, MAT, BULQIZE, KLOS”

Nr. 228/6 prot.

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, Ligjit nr. 2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Diber nr. 17, datë 20.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të K.Q Diber për vitin 2023”, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 20.10.23 pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 18, dt. 20.10.23 “Mbi miratimin e transferimit te fondit Bashkise Diber, Mat, Bulqize, Klos sipas kerkesave te tyre” me 14 (katordhjet) vota pro,

V E N D O S I:

1.Mbi miratimin e transferimit te fondit Bashkise Diber, Mat, Bulqize, Klos sipas kerkesave te tyre.

2.Të bëhet transferimi në shumën 1 400 000 lekë :

- Qendra Kulturore Diber 500 000 lekë
- Shoqata Kulturore “Oda Dibrane” 300 000 leke
- Bashkisë Mat 200 000 lekë
- Bashkise Klos 200 000 leke
- Bashkise Bulqize 200 000 leke

3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Projekteve, dhe Sektori i Financës.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

5.U shpall sot, me datë 20.10.2023

ZV/KRYETAR

Armand Gjini

